



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 386/1 Prot.

Tiranë, më 27.02.2025

V E N D I M

Nr. 39, Datë 27.02.2025

Bazuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 150, datë 10.07.2024¹, e paraqitur nga E.K kundër Prof. Dr. P.A, në cilësinë si Përgjegjëse e Departamentit të Letërsisë, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës dhe Prof. Dr. Dh.Sh, në cilësinë si pedagoge në Departamentin e Letërsisë, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës, me pretendimin për diskriminim për “*çdo shkak tjetër*”².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me shkresën e protokolluar me tonën nr. 1028/1, datë 25.07.2024, subjekti ankues, ka parashtruar se: “*Jam lektore në Departamentin e Letërsisë, Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë. Në datën 26.01.2024, kam paraqitur dosjen për fitimin e titullit akademik “Profesor i asociuar” në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës. Në datën 25.03.2024, jam njohur me refuzimin e Departamentit të Letërsisë për fitimin e titullit. Dosja u kthye së bashku me shkresën përcjellëse nr. 76/3, datë 18.03.2024, të Dekanit të Fakultetit. Pasi jam njohur me shkresën refuzuese kam konstatuar se në*

¹ Ankesa është plotësuar me informacionin e dërguar nga ankuesja me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 1028/1, datë 25.07.2024.

² “Për shkak se ankuesja në vitin 2022, ka qenë recensuese për tekstin e Abetares, ku dy nga pesë autorët për shtëpinë botuese Mediaprint, kanë qenë, znj. P.A dhe znj. Dh.Sh, abetare e cila është renditur jofituese”.

vendimmarrje kanë marrë pjesë Prof. Dr. P.A, si Përgjegjëse e Departamentit dhe Prof. Dr. Dh.Sh, si relatore dhe njëkohësisht anëtare e njësive bazë/departamentit.

Vlerësoj se nga të dy pedagogët e mësipërme jam viktimizuar në të gjithë procedurën e marrjes së titullit, pasi me të dy pedagogët kam patur marrëdhënie “armiqësore” ose ndryshe konflikt interesi. Gjithashtu mendoj se të dy profesorët kanë ushtruar ndikim edhe tek pjesa tjetër e anëtarëve të njësive bazë në votimin që është bërë.

Çmoj se konflikti i interesit ka lindur në vitin 2022, ku unë jam caktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit si recensuese³ për tekstin e vetëm “Abetare” që do të miratohej zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë dhe Kosovës, mes konkursit. Një ndër abetaret që kam recensuar dhe renditur jofituese ka qenë edhe Abetarja e përbashkët Shqipëri-Kosovë, e shtëpisë botuese “Mediaprint” dhe “Shkronjat”. Dy ndër pesë autorët e kësaj Abetareje kanë qenë edhe Prof. Dr. P.A dhe Prof. Dr. Dh.Sh.

Recensa vlerësuese është bërë e sekretuar pa e ditur ne, grupi i punës se kujt i përkiste abetarja apo cilët ishin autorët e saj. Pasi kemi dhënë vlerësimin, në datën 20.06.2022, autorët e kësaj abetareje kanë paraqitur një kërkesë për rivlerësim, drejtuar çdo recensuesi në emër. Ky është dhe momenti kur kam parë emrin e dy autorëve në Abetaren e skualifikuar.

Ka qenë pikërisht ky fakt që ka krijuar zanafillën e “armiqësisë” dhe marrëdhënieve të tensionuara dhe njëkohësisht konfliktin e interesit. Kjo lloj marrëdhënie me dy pedagogët vlerësoj se ka ndikuar që në nisje të procedurës për marrjen e titullit në njësinë bazë/departament e deri në përfundimin e vlerësimit paraprak, ku nëpërmjet viktimizimit e shqetësimit, në mënyrë të padrejtë, më rrëzuan të gjithë veprimtarinë time akademike e shkencore për botimet që unë kam paraqitur në dosje. Në vlerësimin paraprak që më kanë bërë janë dhënë vlerësime dhe qëndrime që tejkalojnë dhe të drejtën që ligji iu ka dhënë, pasi kanë mbajtur qëndrime deri personale, jo objektive, të ndikuara nga ky konflikt që ka nisur në vitin 2022.

Viktimizimi e shqetësimi ka vazhduar edhe pas refuzimit të marrjes së titullit për shkak të ankesave që kam bërë për marrje informacioni, sa i përket kopjes së vendimit refuzues, kopjes së procesverbalit të mbledhjes së departamentit ku është vendosur refuzimi i titullit, mënyrës së votimit (mbledhje në departament apo online), pjesëmarrësit në votim, kuorumin e caktuar për hapjen e mbledhjes, numrin e votuesve. Dy herë, me shkresat e datave 17 dhe 30 prill 2024, mbi kërkesën time, departamenti më ka diskriminuar, pasi haptazi në kundërshtim me ligjin (rregulloren) nuk më ka vënë në dispozicion kopje të akteve, në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, duke më vënë në dyshime të arsyeshme për parregullsi; se vendimi refuzues mund të mos jetë marrë në mënyrën e parashikuar në ligj; se mbledhja mund të mos jetë bërë në formën dhe procedurën e parashikuar, si dhe ka patur votues në favorin tim, rrethanë e cila nuk është përmendur në përgjigjet që më janë dhënë zyrtarisht”.

³ Pesë recensues kanë qenë nga Shqipëria dhe 5 recensues kanë qenë nga Kosova.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe detyrimin e departamentit/njesisë bazë të rishqyrtojë dosjen në mënyrë objektive duke shmangur pjesëmarrjen e Prof. Dr. P.A dhe Prof. Dr. Dh.Sh.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010, *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Bazuar në nenin 7 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*⁴, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në nenin 20/1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”*.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010, *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

- Me shkresën nr. 1028/2, datë 31.07.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjektet kundër të cilëve ishte bërë ankesa, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Argumentimin Tuaj (Prof. Dr. P.A dhe Prof. Dr. Dh.Sh), lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
 - Kopje të plotë të dokumentacionit të procedurës së ndjekur lidhur me shqyrtimin e dosjes së E.K.
 - Informacion lidhur me procedurën e ndjekur për përzgjedhjen e relatorëve, të njoftimit të anëtarëve të departamentit dhe organizimit të mbledhjes së departamentit për shqyrtimin e dosjes së E.K (kopje të procedurave).
 - Informacion dhe kopje dokumentacioni, nëse ka dhe pedagogë të tjerë, dosjet e të cilëve nuk i plotësonin standardet për të vijuar me procedurat e mëtejshme në kërkim të titullit akademik, të cilët janë në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesen.
 - Informacion lidhur me procedurën e ndjekur për caktimin e relatorëve në raste të tjera të shqyrtimit të dosjeve të pedagogëve për fitimin e titullit akademik, në Departamentin e Letërsisë.
 - Informacion nëse në Departamentin e Letërsisë, ka pasur raste që drejtues apo anëtarë të departamentit kanë deklaruar pasjen e konfliktit të interesit, për raste kur janë caktuar në detyra të ndryshme apo kur është dashur që të shprehen me votë.
 - Kopje të plotë të dokumentacionit të procedurës së ndjekur lidhur me shqyrtimin e dosjes së E.K, të vitit 2022.

Me shkresën me nr. 766/1, datë 02.08.2024, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, informoi Komisionerin se: *“Ju bëjmë me dije se stafi akademik i Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, ku bën pjesë edhe Departamenti i Letërsisë, anëtarë të të cilit janë, Pror. Dr. P.A dhe Prof. Dr. Dh.Sh, është me leje vjetore. Për këtë arsye, informacionin e kërkuar do të mund ta keni pas datës 02.09.2024, kur stafi të kthehet nga leja vjetore”.*

Me shkresën nr. 1028/4, datë 12.09.2024, *“Kujtesë”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar parashtrime nga subjektet kundër të cilëve ishte bërë ankesa.

Me shkresën nr. 766/3, datë 04.09.2024, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, dërgoi një pjesë të dokumentacionit të kërkuar.

Me shkresën nr. 2631/1, datë 19.09.2024, Universiteti i Tiranës, informoi Komisionerin se: *“Në vijim të ankesës së E.K, mbi pretendimin e saj se dosja për fitimin e titullit Prof.Asoc.Dr. nuk është shqyrtuar në mënyrë objektive nga Departamenti i Letërsisë, ju informojmë se, në rang institucional Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA) ka ngritur një grup pune për shqyrtimin e ankesës së saj, ndërkohë që E.K është njoftuar për dorëzimin e praktikës pranë këtij institucioni. Ju bëjmë me dije se, në përfundim të procedurës verifikuese, do ju informojmë mbi rezultatin e saj”.*

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 1028/7, datë 11.10.2024 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 24.10.2024, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Informacion lidhur me procedurën e ndjekur për përzgjedhjen e relatorëve, të njoftimit të anëtarëve të departamentit dhe organizimit të mbledhjes së departamentit për shqyrtimin e dosjes së E.K (kopje të procedurave).
 - Informacion dhe kopje dokumentacioni, nëse ka dhe pedagogë të tjerë, dosjet e të cilëve nuk i plotësonin standardet për të vijuar me procedurat e mëtejshme në kërkim të titullit akademik, të cilët janë në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesen.
 - Informacion lidhur me procedurën e ndjekur për caktimin e relatorëve në raste të tjera të shqyrtimit të dosjeve të pedagogëve për fitimin e titullit akademik, në Departamentin e Letërsisë.
 - Kopje të plotë të shkresave: nr. 76/2, datë 13.03.2024, nr. 76/5, datë 17.04.2024, nr. 76/8, datë 30.04.2024 dhe nr. 76/10, datë 09.05.2024.

Seanca u zhvillua në datë 24.10.2024, me praninë e subjektit ankues personalisht, dhe përfaqësuesit me autorizim të Universitetit të Tiranës, z. G.T⁵.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, si dhe dorëzoi parashtrimet me shkrim.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Universitetit të Tiranës, dorëzoi parashtrimet me shkrim si dhe në mes të tjerash deklaroi se: *“Universiteti i Tiranës funksionon si një i tërë, me pjesë integrale të tij fakultetet, departamentet dhe strukturat e tjera të miratuara me vendime të senatit akademik, siç është dhe KPPA. Duke qenë se në këtë çështje është integriteti i Universitetit të Tiranës, ankesa është duke u shqyrtuar edhe nga KPPA-ja. Pasi dëgjuam pretendimet e ankueses, ne do dëshironim që të kishim dhe një vendim të KPPA-së, në mënyrë që të hiqej çdo lloj dyshimi që këtu ka pasur një vendimmarrje të ndikuar nga konflikti i interesit, si viktimizim, etj. Ju informoj se titullin akademik në fushën e kërkimit shkencor që pretendon ankuesja e jep vetëm Universiteti i Tiranës për të gjithë Shqipërinë. Ankuesja pranoi se dhe në vitin 2024 ka bërë aplikimin e të njëjtës dosje, por me dokumentacion shtesë. Në të dy rastet ankuesja e ka ditur se është vendimmarrje e Departamentit të Letërsisë, si në vitin 2022 dhe në vitin 2024. Kur bëri aplikimin në rastin e dytë, e ka ditur shumë mirë se janë të njëjtët persona dhe ka pasur të gjitha mundësitë që të bënte një kërkesë për përjashtimin e këtyre pedagogëve, sepse nuk e ndalonte ligji. Procedura e fitimit të titullit akademik përcaktohet nga rregullorja e KPPA-së, kur dosja shkon atje. Në nivel departamenti kemi të bëjmë me një procedurë verifikuese, pra departamenti bën verifikimin e*

⁵ Autorizimi nr. 2987/1, datë 22.10.2024, i Universitetit të Tiranës.

dosjes dhe rëndësi në këtë fazë të procesit është nëse një kandidat për titull i plotëson apo jo kushtet apo kriteret”.

Në vijim ankuesja me email-in datë 27.10.2024, ka dërguar parashtime dhe në mes të tjerash informon se: “Diskriminimi pretendohet se të dy profesorët, gjatë trajtimit të kërkesës sime për të fituar titullin “Profesor i Asociuar” njëra në cilësinë e relatores (znj. Dh. Sh) dhe tjetra në cilësinë e Përgjegjëses së Departamentit të Letërsisë (znj. P.A), nuk kanë shprehur konfliktin e interesit/pengesën ligjore për të trajtuar kërkesën, pasi kanë arsye serioze për njëanshmëri në procedurën administrative në shqyrtim. Jam diskriminuar në mënyrën sesi është trajtuar puna ime shkencore, duke u marrë drejtpërdrejtë me figurën time personale, aq sa vura në pikëpyetje aftësitë e mija.

Gjithçka ka nisur në vitin 2022, kur unë u shpalla recensuese për tre Abetaret, nga të cilat Abetarja e profesorëve në fjalë shpallet jofituese.

Megjithëse znj. P.A dhe znj. Dh.Sh nuk kanë deklaruar “kryesisht” me iniciativën e tyre, arsyet serioze të njëanshmërisë, të cilat shkaktojnë konflikt interesi dhe pengesë ligjore, për shqyrtimin e dosjes përkatëse. Kam qenë në pamundësi objektive për të kundërshtuar njëanshmërinë e dy profesorëve, duke kërkuar përjashtimin e tyre, pasi rrethanat me të cilat u provua kjo njëanshmëri, kanë ndodhur pasi kam marrë dijeni për refuzimin e kërkesës sime.

Në refuzimin e aplikimit tim shkruhet se artikujt nuk kanë qenë të renditura në Scopus, që nuk është e vërtetë. Thuhet se artikujt janë botuar jashtë fushave të formimit, se artikujt janë divulgativë dhe se kam mungesë të metodologjisë së kërkimit shkencor. Kjo gjuhë fyese më ka cenuar integritetin duke dhënë qëndrime dhe vlerësime që tejkalojnë çdo ligj dhe duke kaluar në qëndrime personale. Unë përfaqësoj një lektore me gradë më të ulët dhe vij nga një universitet nga rrethet e jugut. E them këtë pasi ata më janë përgjigjur dhe penalizuar për nivelin e kumtesave, të cilat janë vlerësuar nga auditori ku kam referuar, me debat pyetje-përgjigje siç ndodh nëpër konferenca, aq më tepër që janë botuar nga një bord shkencor”.

Në vijim pas seancës dëgjimore, Universiteti i Tiranës me email-in datë 11.11.2024, dërgoi parashtime të Universitetit të Tiranës, të KPPA-së, të Prof.Dr. P.A dhe Prof.Dr. Dh.Sh.

Në shkresën datë 11.11.2024, Universiteti i Tiranës, në mes të tjerash ka informuar se: “Në ankimin e paraqitur, ankuesja ka pretenduar se, dy nga anëtarët, pjesëmarrës në vlerësimin e dosjes së saj pranë Departamentit të Letërsisë, kanë qenë në kushtet e konfliktit të interesit.

Bëjmë me dije, para Komisionerit, se në ankimin e paraqitur pranë Universitetit të Tiranës, ankuesja nuk ka paraqitur asnjë pretendim në lidhje me vlerësimin që Departamenti i Letërsisë i ka bërë dosjes së saj dhe mbi të gjitha, shkakut të refuzimit.

Në relacionin mbi dosjen e ankueses, Departamenti i Letërsisë, ka parashtruar në mënyrë konkrete se:

“..... Në dosjen e Dr. E.K, rezulton se revistat ku janë botuar artikujt, nuk kanë qenë të rankuara në Scopus në periudhat e dorëzimit për botim dhe të botimit. Po ashtu vërehen mospërputhje mes të dhënave që figurojnë në dëshmitë dhe materialet e dorëzuara, me ato që shfaqen online me po ato të dhëna. Duke qenë se përfundimisht asnjë prej artikujve të dorëzuar nuk rezulton i rankuar në Scopus (ose Web of Science), u konstatua se dosja e kandidatës Dr. E.K nuk plotëson një nga standardet kryesore për fitimin e titullit “Profesor i asociuar”.....”.

Me shkresën datë 04.11.2024, Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik, ka përcjellë vlerësimin e Anëtarëve të Komisionit, citojmë: “..... Në përfundim të vlerësimit, Sugjerojmë që kandidatja E.K të plotësojë kriterin e botimit në revista të indeksuara në SCOPUS/Web of Science në përputhje me VKM/2018, i ndryshuar”.

Vlerësimi i KPPA-së është tregues i objektivitetit të vlerësimit të dosjes së kandidatës për titull E.K nga Departamenti i Letërsisë, në Fakultetin e Histori dhe Filologji të UT-së”.

Me shkresën datë 11.11.2024, znj. P.A, në mes të tjerash informoi se: “Në cilësinë e përgjegjëses së Departamentit të Letërsisë, ju bëj me dije se Departamenti i Letërsisë ushtron funksionet dhe detyrat e veta në shqyrtimet e dosjeve të aplikantëve për tituj akademikë duke u mbështetur në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, përkatësisht në nenet 60/3 dhe 79/7, dhe në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e KPPA-së të UT-së, duke u bazuar në VKM nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “profesor i asociuar” dhe “profesor”, plotësuar së fundmi edhe me VKM nr. 128, datë 06.03.2024.

Departamenti ka shqyrtuar dhe ka përcjellë për procedura të mëtejshme me miratimin e tij unanim disa dosje aplikimi për titullin akademik “Profesor i asociuar”, duke krijuar një përvojë të mirë e cilësore. Deri më sot, me përjashtim të Dr. E.K, dosjet e paraqitura nga kandidatët e tjerë i kanë përmbushur të gjitha standardet e parashikuara nga ligji.

Në rastin e dosjes së Dr. E.K u konstatua unanimisht mospërmbushja e standardeve të parashikuara në legjislacionin përkatës.

Në dosjen e Dr. E.K rezulton se revistat ku janë botuar artikujt, nuk kanë qenë të rankuara në Scopus në periudhat e dorëzimit për botim dhe të botimit. Po ashtu vërehen mospërputhje mes të dhënave që figurojnë në dëshmitë dhe materialet e dorëzuara, me ato që shfaqen online me po ato të dhëna. Duke qenë se përfundimisht asnjë prej artikujve të dorëzuar nuk rezulton i rankuar në Scopus (ose Web of Science), u konstatua se dosja e kandidatës Dr. E.K nuk plotëson një nga standardet kryesore për fitimin e titullit “Profesor i asociuar”.

Gjithashtu u konstatua se në tërësi, ana përmbajtësore e artikujve dhe konferencave të paraqitura në dosjen e aplikantes, shfaqte disa problematika, si për shembull:

- Disa artikuj janë botuar në organe me fokus jashtë fushave të formimit të kandidates (mjekësi, inxhinieri); ose vetë artikulli është i tillë (gjenerativizëm, gjuhësi);
- Artikujt janë thellësisht divulgativë, shfaqin mungesë të thellë të metodologjisë së kërkimit shkencor dhe varfëri në referencat shkencore;
- Mungesa e analizës dhe e metodologjisë shkencore të artikujve shpesh zëvendësohet nga përjetimi emocional i autores;
- Pjesa më e madhe e artikujve lidhen me didaktikën, procesin e mësimdhënies, por janë të nivelit përshkrues, të leksionit për studentë, nuk ngrenë e nuk zgjidhin çështje të karakterit shkencor. Ndalen në rolin e mësuesit, organizimin e orës së mësimi, tipet e pyetjeve, çështje këto shumë larg aspekteve të karakterit shkencor.

Për rrjedhojë ka rezultuar se dosja e kandidates nuk i plotëson standardet formale dhe përmbajtësore për vijimin e procedurës së aplikimit për fitimin e titullit akademik “Profesor i asociuar”.

Në përmbyllje të shqyrtimit të kësaj dosjeje, Departamenti i Letërsisë, është shprehur pa ekuivok, për ta vlerësuar e cilësuar dosjen e paraqitur nga Dr. E.K si një dosje që nuk i plotëson kriteret për të vijuar me procedurat e mëtejshme në kërkim të titullit “Profesor i asociuar”.

Mendoj se të konstatosh me profesionalizëm se një dosje nuk i përmbush standardet ligjore, nuk përbën kurrsesi diskriminim të autorit të saj. Ngritja e një supozimi të tillë ndaj meje përbën një fyerje të rëndë ndaj integritetit tim profesional dhe njerëzor. Ekzistenca ose jo e një ose më shumë artikujve në Scopus është e verifikueshme në mënyrë objektive dhe nuk mund të përbëjë në asnjë rast një qëndrim subjektiv nga askush. Gjithashtu, edhe të konstatosh me profesionalizëm dhe në detyrimin që na vendos kuadri ligjor për përmbushjen e standardeve të tjera të një dosjeje kandidature për titull akademik, nuk mund të përbëjë në asnjë rast e për asnjë arsye diskriminim. Natyra divulgative, mungesa e thellë e metodologjisë së kërkimit shkencor, varfëria në referencat shkencore, mungesa e analizës, etj, janë të verifikueshme objektivisht në artikujt e paraqitur në dosjen e kandidates. Të gjitha konstatimet për mospërmbushje të theksuar standardesh të parashikuara ligjërisht, janë arritur gjatë shqyrtimit që unë personalisht i kam bërë dosjes dhe kanë përkuar tërësisht me konstatimet e bëra nga relatorët e dosjes (me titullin më të lartë akademik) si dhe me konstatimet e të gjithë anëtarëve të Departamentit në mbledhjen përkatëse. Anëtarët e Departamentit të Letërsisë janë pjesë e rëndësishme dhe e nderuar e personelit pedagogjik të UT-së dhe në asnjë rast e për askënd nuk do të hiqnin dorë nga profesionalizmi dhe objektiviteti i tyre për të ushtruar detyrat që u njeh ligji”.

Me shkresën datë 11.11.2024, znj. Dh.Sh, në mes të tjerash informoi se: “Në cilësinë e relatores së dosjes së Dr. E.K, detyrë e ushtruar sipas neneve 60/3 dhe 79/7, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 128, datë 06.03.2024, VKM nr. 808, datë 11.12.2018, dhe VKM nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “doktor”

dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve Akademikë “profesor i asociuar” dhe “profesor”, sqaroj si më poshtë vijon:

- Në lidhje me plotësimin e kushteve që vendos kuadri ligjor e nënligjor mbi standardet që duhen përmbushur për të shfaqur zotërimin e plotë të fushës kërkimore ku aplikohet, duke u kërkuar që të jenë realizuar nga ana e kandidatës detyrimet e mëposhtme:
- a) 1. Të ketë botuar, së paku 5 (pesë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara.
- a) 2. Së paku, 2 (dy) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI).
- a) 3. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë në, të paktën, 2 (dy) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;

rezulton se revistat ku janë botuar artikujt, nuk kanë qenë të rankuara në Scopus në periudhat e dorëzimit për botim dhe të botimit.

Për rrjedhojë, duke qenë se asnjë prej artikujve të dorëzuar nuk rezulton i rankuar në Scopus (ose Web of science), konfirmoj se dosja e kandidatës E.K nuk plotëson standardet për fitimin e titullit Prof. Asoc.

Në lidhje me anën përmbajtësore të artikujve dhe të konferencave vërehet se:

1. Disa artikuj janë botuar në organe me fokus jashtë fushave të formimit të kandidatës (mjekësi, inxhinieri); ose vetë artikulli është i tillë (gjenerativizëm, gjuhësi);
2. Artikujt janë thellësisht divulgativë, bie në sy mungesa e thellë e metodologjisë së kërkimit shkencor dhe varfëria në referencat shkencore. Mungesa e analizës dhe e metodologjisë shkencore të artikujve shpesh zëvendësohet nga përjetimi emocional i autores;
3. Pjesa më e madhe e artikujve lidhen me didaktikën, procesin e mësimdhënies, por janë të nivelit përshkrues, të leksionit për studentë, nuk ngrenë e nuk zgjidhin çështje të karakterit shkencor. Ndalen në rolin e mësuesit, organizimin e orës së mësimi, tipet e pyetjeve, çështje këto shumë larg aspekteve të karakterit shkencor.
4. Ka mjaft përsëritje mes artikujve dhe konferencave, të cilat mbeten në kufijtë që përmendëm më lart, etj.

Për sa më lart, kam dalë në përfundimin se kandidatja nuk i plotëson standardet formale dhe përmbajtësore për vijimin e procedurës së aplikimit për fitimin e titullit akademik “Profesor i asociuar”.

Siç mund të vëreni, mospërmbushja e standardeve në dosjen e paraqitur nga kandidatja është lehtësisht e faktueshme dhe nuk përbën aspak një qëndrim subjektiv. Ky gjykim mbi

mospërbushjen e standardeve përkon edhe me gjykimin që Departamenti ka dhënë, në mënyrë të pavarur prej meje. Çdo insinuatë për qëndrim jo profesional, e aq më tepër diskriminues nga ana ime është e pabazë”.

Me shkresën nr. 766/9, datë 26.11.2024, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë i UT-së dërgoi dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri me shkresën nr. 1028/7, datë 11.10.2024.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

LMD, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij*”.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me persona të tjerë, në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “*krahasuesi*”. Në rastet dhe kushtet kur ky “*krahasues*” mungon,

vlerësohet nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, në raport me parashikimet ligjore që normojnë fitimin e titullit akademik.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Në datën 26.01.2024, ankuesja ka paraqitur dosjen për fitimin e titullit akademik “Profesor i asociuar” në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës.

Me shkresën nr. 76/1, datë 29.01.2024, Dekani i Fakultetit Histori dhe Filozofi ka përcjellur për procedurë dosjen e ankueses, Departamentit të Letërsisë.

Me shkresën nr. 76/2, datë 13.03.2024, Departamenti i Letërsisë ka përcjellë raportin e plotë, relacionin e relatorëve dhe dosjen e ankueses, Dekanit të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, në të cilin e informon se, Departamenti i Letërsisë në përfundim të shqyrtimit të dosjes së paraqitur nga Dr. E.K ka dalë në përfundimin se kjo dosje nuk i plotëson standardet për të vijuar me procedurat e mëtejshme në kërkim të titullit “Profesor i asociuar”.

Me shkresën nr. 76/3, datë 18.03.2024 të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, ankuesja është njohur me vlerësimin e dosjes së saj.

Ankuesja pretendon se nga dy pedagoget Prof. Dr. P.A dhe Prof. Dr. Dh.Sh, është viktimizuar në të gjithë procedurën e marrjes së titullit, pasi me të dy pedagoget ka patur marrëdhënie “armiçësore” ose ndryshe konflikt interesi dhe se të dy profesorët kanë ushtruar ndikim edhe tek pjesa tjetër e anëtarëve të njësisë bazë në votimin që është bërë.

Bazuar në rastin objekt shqyrtimi, Komisioneri ka analizuar legjislacionin si më poshtë:

Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 3⁶ të tij ka përcaktuar se:

“1. Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Liria akademike garantohet nëpërmjet së drejtës:

- a) për të organizuar veprimtarinë e mësimdhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese;*
- b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore;*
- c) për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik”.*

Neni 33, pika 3 e tij, e këtij Ligji, përcakton se:

⁶ Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë.

“Institucionet e arsimit të lartë dhe njësitë e tyre përbërëse rregullojnë veprimtarivë e tyre në rregulloret e tyre të brendshme, që hartohen dhe miratohen në përputhje me këtë ligj dhe sipas mënyrës së përcaktuar në statutin e institucionit të arsimit të lartë”.

Në nenin 45, të këtij ligji përcaktohet se: “1. Drejtuesi i njësisë bazë është drejtuesi i departamentit ose i qendrës kërkimore-shkencore. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përfaqëson atë. Në institucionet publike të arsimit të lartë ai zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë bazë... 4. Drejtuesi mund të shërbejë në detyrë për një mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë... 6. Funksionet e drejtuesit të njësisë bazë rregullohen në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë”.

Neni 61. Fitimi i titujve akademikë

1. Për fitimin e titullit “Profesor i asociuar” mund të aplikojë personeli akademik që gëzon gradën shkencore “Doktor”, prej së paku pesë vitesh, është personel akademik i kategorisë “Lektor” dhe përmbush standardet shtetërore për fitimin e titullit. Për fitimin e titullit “Profesor” mund të aplikojë personeli akademik që gëzon prej së paku pesë vjetësh titullin “Profesor i asociuar”, si dhe përmbush standardet shtetërore për fitimin e titullit.

2. Personeli akademik i institucioneve të arsimit të lartë, të cilat nuk përmbushin kriteret për dhënien e titujve akademikë, si dhe personat, të cilët nuk janë personel akademik pranë ndonjë institucioni, por përmbushin standardet për fitimin e titujve, paraqesin kërkesën pranë një institucioni, i cili përmbush kriteret për dhënien e titujve.

3. Kandidati për fitimin e titullit “Profesor i asociuar” ose “Profesor” paraqet dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore. Dosja e kandidatit i përcillet senatit akademik, pas paraqitjes dhe vlerësimit në njësinë bazë. Senati i kalon dosjen Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, i cili merr vendimin përfundimtar pas vendimit të jurisë mbi përmbushjen e standardeve. Titulli regjistrohet në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin. Titulli akademik lëshohet nga institucioni dhe firmoset nga rektori.

4. Në rast vlerësimi negativ të kërkesës për fitimin e titujve akademikë nga Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, kandidatit i lind e drejta të ripërsërisë kërkesën pas një periudhe kohore jo më të shkurtër se dy vjet.

Neni 60.

3. Standardet shtetërore për fitimin e titujve “Profesor” dhe “Profesor i asociuar” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 79.

7. Këshilli i Ministrave miraton kriteret që duhet të përmbushë kandidati për fitimin e grades shkencore “Doktor”, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe standardet për fitimin e titujve akademikë “Profesor” dhe “Profesor i asociuar”.

Në Kreun II, të VKM-së nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor””, i ndryshuar me VKM 808/2019, parashikohet se:

STANDARDET PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK “PROFESOR I ASOCIUAR”

1. Titulli akademik “profesor i asociuar” jepet nga institucionet e arsimit të lartë, të llojit “Universitet”, të cilat plotësojnë kriteret ligjore dhe ato të përcaktuara në këtë vendim.
2. Aplikimet për fitimin e titullit akademik “profesor i asociuar” kryhen nga anëtarët e personelit akademik të kategorisë “Lektor”.
3. Personeli akademik i kategorisë “lektor” aplikon për fitimin e titullit akademik “profesor i asociuar” të paktën 5 (pesë) vjet, nga data që ka mbrojtur gradën shkencore “doktor”.
4. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin “profesor i asociuar”, duhet:
 - a) të ketë zhvilluar një cikël të plotë leksionesh për, së paku, një lëndë, për 3 (tri) vite akademike;
 - b) të ketë përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë, së paku, 5-vjeçare (pesëvjeçare), me apo pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme si lektor, për një periudhë 8-vjeçare (tetëvjeçare) akademike, me apo pa ndërprerje, pas fitimit të gradës shkencore “doktor”;
 - c) të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle ose të mbrojë veprimtarinë kërkimore botuese përpara Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, në një nga gjuhët e mësipërme, në përputhje me statutin dhe rregulloren e IAL-së.
5. Personeli akademik, që aplikon për titullin “profesor i asociuar”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:
 - a) Ka botuar, së paku, 5 (pesë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 2 (dy) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga “Journal Citation Reports” dhe/ose Scopus. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autori i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë në, të paktën, 2 (dy) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;
 - b) Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku, 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

6. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 4, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:
- a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “doktor”, brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D. Monografite konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “profesorë” të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës.
 - b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:
 - i) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.
 - c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:
 - i) 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.
7. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të gradës shkencore “doktor”, në:
- a) komitete shkencore apo redaktuese;
 - b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
 - c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;
 - ç) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
 - d) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
 - dh) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - e) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - ë) projektet e transferimit teknologjik të patentave.

8. *Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në pikën 7, të këtij kreu, mund të ekuivalentohet me:*

- a. *1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti;*
- b) *1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit dhe 2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.*

9. 10.

11. *Për fitimin e titullit akademik “profesor i asociuar”, botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së gradës shkencore “doktor”, deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik “profesor i asociuar”.*

12. *IAL-të përcaktojnë në rregulloret e tyre përkatëse kriteret për vlerësimin akademiko-didaktik të kandidatëve për fitimin e titujve akademikë.*

Në Kreun IV. PROCEDURAT PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

- 1. *Kandidati paraqet kërkesën dhe dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë brenda 20 (njëzet) ditëve. Pas vlerësimit nga njësisë bazë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, dosja e kandidatit i përcillet Senatit Akademik, i cili, brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e dosjes, ia përcjell Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.*
- 2. *Nëse njësisë bazë jep vlerësim negativ, dosja i kthehet drejtuesit të njësisë kryesore me argumentet dhe sugjerimet përkatëse. Kandidati ka të drejtë të aplikojë sërish, brenda një afati kohor prej 6 (gjashtë) muajsh. Vendimi i njësisë bazë merret nga shumica e anëtarëve të saj.*
- 3. ”.

Në Statutin e Universitetit të Tiranës, parashikohet se:

“Neni 50. Drejtuesi i njësisë bazë/departamentit

- 1. *Drejtuesi i njësisë bazë është drejtuesi i departamentit ose i qendrës kërkimore-shkencore. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përfaqëson atë. Në institucionet publike të arsimit të lartë ai zgjidhet nga asamblja e personelit akademik të njësisë bazë. Ai zgjidhet nga personeli akademik sipas përcaktimeve ligjore dhe duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:*

Neni 51. Funksionet e drejtuesit të departamentit

1. Drejtuesi i departamentit ushtron këto funksione:

- a) Është përgjegjës për mbarëvajtjen e veprimtarisë së njësisë dhe përmbushjen e detyrave të saj.
- b) Mbikëqyr shpërndarjen e ngarkesës mësimore të anëtarëve të njësisë sipas drejtimeve të përcaktuara nga njësia dhe sigurohet për përmbushjen e saj;
- c) Mbikëqyr veprimtaritë shkencore në departament, në përputhje me planifikimin vjetor, mban dokumentacionin e aktivitetit shkencor e akademik të personelit akademik të departamentit, pas raportimeve në analizën vjetore të tij;
- ç) Mbikëqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën e në mënyrën e caktuar dhe të kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera;
- d) Mbikëqyr paraqitjen dhe disiplinën në punë të anëtarëve të njësisë duke u siguruar për mbarëvajtjen e përmbushjes së detyrimeve dhe njëkohësisht të të drejtave të anëtarëve të njësisë bazë;
- dh) Paraqet në dekanat kërkesat me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare të njësisë bazë; .

.....

2. 3.

4. Përgjegjësi i departamentit, në ushtrim të funksioneve të tij, shprehet sipas rastit me vendime, urdhra dhe udhëzime”.

Në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Tiranës”, të miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 21, datë 27.07.2022, parashikohet se:

Neni 21. Procedurat e aplikimit.

1. Kandidati që kërkon të promovohet, paraqet kërkesën dhe dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ja përcjell për vlerësim njësisë bazë, brenda 20 (njëzet) ditëve nga paraqitja e kërkesës.
2. Dosja e aplikimit duhet të përmbajë këto dokumente:
 - a) b), etj.

Neni 22. Të drejtat dhe detyrimet e kandidatit për fitimin e titullit akademik

1. Të drejta të kandidatit:
 - a. të paraqesë kërkesën dhe dosjen për fitimin e titullit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore në fuqi dhe kësaj rregulloreje;
 - b. të kërkojë informacion për ecurinë e procedurës së aplikimit dhe vlerësimet;

- c. të kërkojë informacion për vendimet e marra në të gjitha nivelet lidhur me aplikimin që ka paraqitur;
 - d. të paraqesë ankesë lidhur me procedurat dhe vendimet e marra për fitimin e titullit;
 - e. të përsërisë kërkesën brenda afatit kohor të parashikuar në VKM nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar, përkatësisht brenda 6 (gjashtë) muajve nga refuzimi nga njësia bazë, ose pas një periudhe jo më të shkurtër se 2 (dy) vjet nga refuzimi i KPPA.
2. Detyrime të kandidatit:

Neni 23. Detyrat e njësisë bazë dhe drejtuesit të njësisë kryesore

A) Detyra të njësisë bazë

Njësia bazë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike nga marrja në dorëzim e dosjes së kandidatit nga drejtuesi i njësisë kryesore, vlerëson paraprakisht dosjet e kandidatëve për titullin akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”, përpara paraqitjes së tyre Senatit Akademik i cili, brenda 20 (njëzet) ditëve ia përcjell Komisionit. Vlerësimi kryhet në përputhje me standardet shtetërore të përcaktuara në VKM nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar, si dhe në këtë Rregullore.

1. Njësia bazë cakton 2 (dy) relatorë për vlerësimin e përmbushjes së standardeve shtetërore për titujt akademikë nga kandidati. Caktimi i relatorëve kryhet sipas këtyre kritereve:
 - a. relatorët, si rregull, duhet të jenë personel akademik me kohë të plotë të njësisë bazë ku shqyrtohet dosja. Nëse njësia bazë nuk ka personel akademik i cili përmbush kriteret për të qenë relator, ka të drejtë të propozojë si të tillë, personel akademik nga njësiti e tjera bazë të njësisë kryesore ose njësi të tjera të UT-së, të së njëjtës fushë ose të ngjashme me atë të kandidatit;
 - b. relatorët për kandidatin që aplikon për titullin akademik “Profesor i Asociuar”, mbajnë titullin akademik “Profesor” dhe/ose “Profesor i Asociuar”;
 - c. relatorët për kandidatin që aplikon për titullin akademik “Profesor”, mbajnë titullin akademik “Profesor”;
 - d. relatorët, si rregull, përzgjidhen në përputhje me fushën nga vjen kandidati;
 - e. relatorët propozohen nga drejtuesi i departamentit dhe miratohen nga departamenti.
2. Relatorët e njësisë bazë përgatisin relacionin e raportimit për përmbushjen e standardeve shtetërore të titujve akademikë nga kandidati, sipas formatit të miratuar nga Komisioni dhe e firmosin atë në çdo faqe.
3. Njësia bazë përgatit raportin për angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit për veprimtaritë e parashikuara në pikën 7 të kreut II dhe pikën 6 të kreut III të VKM. nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar dhe sipas nenit 20 të kësaj rregulloreje.
4. Njësia bazë, pasi njihet me relacionet e relatorëve dhe raportin përkatës, merr vendim miratues ose refuzues me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të saj.

5. *Njësia bazë i dërgon drejtuesit të njësisë kryesore, me shkresë përcjellëse, vendimin e njësisë bazë, relacionet e firmosura të dy relatorëve, raportin sipas pikës 4 të këtij neni, dokumentacionin original të printuar të dosjes së kandidatit dhe 2 (dy) kopje elektronike të gjithë dokumentacionit të regjistruar në CD.*

B) Detyra të drejtuesit të njësisë kryesore

1. 2.

3. Në rastin kur njësia bazë ka dhënë vlerësim negativ, drejtuesi i njësisë kryesore i kthen kandidatit dosjen me materialet e printuara, vendimin përkatës për vlerësimin negativ, ndërsa njëra nga CD-të arkivohet.

Neni 29. Ankimi për vendimin e vlerësimit

- 1. Çdo kandidat gëzon të drejtën e ankimit ndaj vendimeve dhe procedurave të ndërmjetme të njësisë bazë, njësisë kryesore dhe KPPA, në lidhje me zbatimin e procedurave të ndjekura prej tyre, deri para marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionit.*
- 2. Kandidati mund të paraqesë ankim nëse vendimi është nxjerrë:*
 - a. si rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën e marrjes së vendimeve nga njësia kryesore, njësia bazë, Komisioni;*
 - b. si rezultat i zbatimit të gabuar të akteve ligjore dhe nënligjore;*
 - c. vendimi nuk është i bazuar në fakte dhe provat e paraqitura.*
- 3. Ankimi paraqitet brenda 1 (një) muaji, nga data e njoftimit të vendimit.*
- 4. Ankimi për njësinë bazë/kryesore i drejtohet KPPA-së. Komisioni ngre një komision ad hoc të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh që mbajnë titullin “Profesor”. Komisioni ad hoc shqyrton ankesën, bën verifikimin dhe përgatit relacionin që ia paraqet Komisionit. Nëse e vlerëson, komisioni ad hoc, dëgjon edhe ankuesin në një seancë dëgjimore.*
- 5. Komisioni e shqyrton ankimin dhe merr vendim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga paraqitja e tij.*
- 6. Vendimet e Komisionit pas shqyrtimit të ankimit, janë përfundimtare dhe i njoftohen zyrtarisht ankimuesit nga Kryetari.*

Duke analizuar gjithë sa më sipër, si dhe kronologjinë e veprimeve të kryera nga Departamenti i Letërsisë, Komisioneri vlerëson se:

- Lidhur me propozimin e relatorëve, drejtuesja e Departamentit të Letërsisë, ka ushtruar kompetencën e saj për propozimin e dy relatorëve të dosjes së ankueses, Prof. Dr. Dh.Sh dhe Prof. Dr. L.S, por nuk ka një dokument shkresor në të cilin të evidentohet miratimi i relatorëve nga departamenti (neni 23, A, pika 1/e, i Rregullores KPPA).
- Lidhur me konfliktin e interesit të drejtueses së Departamentit, ankuesja me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 1028/1, datë 25.07.2024, ka pranuar se ka qenë në dijeni se departamenti drejtohej nga Prof. Dr. P.A, për më tepër që dhe kur ka aplikuar për fitimin e

titullit “Profesor i asociuar” në datë 16.05.2022, përsëri Përgjegjëse e Departamentit të Letërsisë ka qenë Prof. Dr. P.A. Në dokumentacionin e dërguar nuk rezulton se ankuesja ka bërë ndonjë kërkesë për përjashtimin e saj dhe të Prof. Dr. Dh.Sh, nga shqyrtimi i dosjes së saj, për shkak të konfliktit të interesit.

- Referuar kritereve që duhet të plotësojnë relatorët, rezulton se ato i përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 23, A, pika 1, të Rregullores së KPPA.
- Referuar relacionit mbi dosjen e Dr. E.K, rezulton se të dy relatorët e dosjes janë shprehur se kandidatja nuk i plotëson standardet formale dhe përmbajtësore për vijimin e procedurës së aplikimit për fitimin e titullit akademik “Profesor i asociuar”.
- Në Raportin e Departamentit të Letërsisë datë 13.03.2024 *“Mbi paraqitjen dhe marrjen në shqyrtim të dosjes së Dr. E.K në kërkim të titullit “Profesor i asociuar””, në mes të tjerash shkruhet se: “Anëtarët e Departamentit të Letërsisë, mbasi kanë dëgjuar relacionin dhe kanë konstatuar edhe nga ana e tyre gjendjen e dosjes së kandidates Dr. E.K, e miratuan relacionin e paraqitur nga relatorët Prof. Dr. L.S dhe Prof. Dr. Dh.Sh dhe u shprehën unanimitisht për ta cilësuar dosjen e paplotë. Si përfundim, në përmbjllje të shqyrtimit të kësaj dosje, Departamenti i Letërsisë, u shpreh në mënyrë unanime dhe pa ekuivok, për ta cilësuar dosjen e paraqitur nga Dr. Ermelinda Kashau si një dosje që nuk plotëson standardet për të vijuar me procedurat e mëtejshme në kërkim të titullit “Profesor i asociuar””.*
- Në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e KPPA, nuk ka të parashikuar dispozita lidhur me: njoftimin e kandidatit me emrat e relatorëve; njoftimin e kandidatit për datën e mbjedhjes së departamentit; dhe mënyrën se si duhet të dokumentohet vendimmarrja e departamentit. Ankuesja nuk solli prova të pretendimit të saj se ndonjë anëtar i departamentit të ishte shprehur kundër relacionit të relatorëve të dosjes apo se ndonjë anëtar i departamentit të ishte shprehur se dosja i plotësonte standardet.
- Për më tepër, Komisioneri evidenton faktin se raporti i vlerësimit i pedagogëve të Departamentit të Letërsisë është miratuar në mënyrë kolegjiale dhe unanime, pavarësisht faktit se Departamenti i Letërsisë nuk është shprehur me vendim⁷ sipas nenit 23, A, pika 4, të Rregullores KPPA. Pra, drejtuesja e departamentit dhe një nga relatorët e dosjes kanë të drejtën e një vote, mes 15 kolegësh⁸, anëtarë të Departamentit të Letërsisë, ndërkohë që vendimi merret me shumicë të thjeshtë.
- Në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e KPPA, nuk ka të parashikuar një procedurë lidhur me konfliktin e interesit që duhet të paraqesin anëtarët e njësisë bazë, megjithatë me shkresën nr. 76/8, datë 30.04.2024, Departamenti i Letërsisë ka informuar Dekanin e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë se: *“Përgjegjësi i Departamentit ka caktuar dy relatorët e dosjes Prof. Dr. L.S dhe Prof. Dr. Dh.Sh. Relatorët janë pyetur*

⁷ Edhe në vitin 2022, kur ankuesja ka aplikuar për herë të parë për fitimin e titullit “Profesor i asociuar”, Departamenti i Letërsisë është shprehur me Raport.

⁸ <https://unitir.edu.al/organika-e-personelit-mesimore-fhf/>

paraprkisht nëse kishin ndonjë pengesë ligjore/konflikti interesi (në lidhje me dosjen dhe autoren e saj) dhe ato kanë konfirmuar se nuk kanë asnjë pengesë të kësaj natyre”.

- Me shkresën nr. 76/3, datë 18.03.2024, Dekani i Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, i ka kthyer dosjen për plotësim, ankueses.

Nuk rezulton që nga ana e ankueses të jetë ankimuar në KPPA, raporti i vlerësimit të Departamentit të Letërsisë, siç është e parashikuar në nenin 29 të Rregullores së KPPA-së.

Bazuar në sa më lart, nga ana e Departamentit të Letërsisë, ka shkelje të procedurës për miratimin në departament të relatorëve të dosjes së ankueses dhe të marrjes së një vendimi nga Departamenti, të cilat Komisioneri nuk i vlerëson të atij niveli, që kanë cënuar rëndë të drejtën e saj, për një vlerësim të dosjes konform parashikimeve të përcaktuara në aktet rregullatore përkatëse dhe që e bëjnë të paligjshëm vendimmarrjen e Departamentit të Letërsisë.

Pavarësisht se ankuesja nuk i është drejtuar me ankesë KPPA-së lidhur me vendimmarrjen e Departamentit të Letërsisë, Rektori i Universitetit të Tiranës dhe Dekani i Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, me shkresën datë 04.11.2024, i janë drejtuar KPPA-së për vlerësimin e dosjes së aplikantes Dr. E.K.

KPPA me shkresën datë 04.11.2024, ka informuar Rektorin e UT-së lidhur me vlerësimin e anëtarëve të KPPA-së për veprimtarinë kërkimore shkencore për fitimin e titullit “*Profesor i asociuar*” të kandidatës Dr. E.K. Në mes të tjerash, në relacion KPPA ka vlerësuar se: “*Pas një vlerësimi të skedës së aplikantes E.K, të dorëzuar në KPPA me 25 Shtator 2024, aplikantja i plotëson kërkesat për vjetërsinë në punë, kohën e dhënies së leksioneve dhe njohjes së gjuhës së huaj.*

Në lidhje me vlefshmërinë e artikujve:

Asnjë nga artikujt e botuar nuk rezulton të jenë të botuar në revista të indeksuara në Scopus.

Në lidhje me përputhshmërinë e botimeve me fushën kërkimore të kandidatës, është departamenti ai që e trajton dhe e vlerëson këtë problem. ...

Në përfundim, sugjerojmë që kandidatja E.K të plotësojë kriterin e botimit në revista të indeksuara në Scopus/Web of Science në përputhje me VKM nr. 112/2018, të ndryshuar”.

Nga ana e Komisionerit, vlerësimi i dhënë nga Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik, i cili është Komisioni kryesor profesional i cili shqyrton dhe vlerëson përmbushjen nga kandidatët të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë, është vlerësuar si informacion i cili i ka dhënë përgjigje dhe vlerësimit përmbajtësor të dosjes së ankueses.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se nuk ka tagër të vlerësojë vendimmarrjen e bërë nga Departamenti i Letërsisë për dosjen e ankueses, por merr të mirëqenë informacionin e

dhënë nga KPPA-ja, e cila ka vlerësuar se ankuesja duhet të plotësojë kriterin e botimit në revista të indeksuara në Scopus/Web of Science.

Në këtë logjikë, Komisioneri vlerëson se, përsa kohë lidhur me sa më sipër, nuk konstaton veprime të paligjshme nga ana e Departamentit të Letërsisë, lidhur me veprimet dhe procedurën e ndjekur për shqyrtimin e aplikimit/dosjes së ankueses, për rrjedhojë edhe pretendimi i ankueses se nga ana e drejtueses së Departamentit të Letërsisë dhe nga Prof. Dr. Dh.Sh, janë ezauruar paligjshmëri e veprime jashtë kompetencave të tyre, nuk qëndron pasi është i pabazuar në prova, fakte e legjislacion.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në nenin 20/1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit, si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji*.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e subjekteve ndaj të cilëve ka paraqitur ankesën.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Prof. Dr. P.A dhe Prof. Dr. Dh.Sh, për shkakun e pretenduar nga ankuesja dhe për rrjedhojë nuk provohet se Prof. Dr. P.A, në cilësinë si Përgjegjëse e Departamentit të Letërsisë, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës dhe Prof. Dr. Dh.Sh, në cilësinë si pedagogë në Departamentin e Letërsisë, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës, kanë shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të E.K, nga ana e Prof. Dr. P.A, në cilësinë si Përgjegjëse e Departamentit të Letërsisë, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës dhe Prof. Dr. Dh.Sh, në cilësinë si pedagoge në Departamentin e Letërsisë, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA